

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE
CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES
AND TOURIST COMPLEXES" SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k.

- 1- **HUSSEEN MAHMUD ABAAS AL-JBUORY** atesia **MAHMUD**, shtetas IRAKIAN, lindur me 14/01/1975 ne IRAK, identifikohet nepermjet pasaportes A14085729.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k.,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.



NENI 3

SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "DESHMORET" Lagja nr. 4, Godina me xhama , afer karburant ALPET , kati i 2 , Zyra 19 , Nr. Pronesie 6/62, zona

kadestrale 8514, Durres, Shqiperi.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në

procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv punime në fushën e ndërtimit.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

| | | |
|--|----------------|------------------------|
| 1. HUSSEEN MAHMUD ABAAS AL-JBUORY | 100,00% | 100.000,00 LEKE |
|--|----------------|------------------------|

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje

Aplicanti:
Anxhela Jfo
Jfo

llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7 AKTET E SHOQËRISE

Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shumë se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF CITIES AND TOURIST COMPLEXES**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezzgatja dhe kompetencat e tyre. Administratorët e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare janë emëruar:


1. HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY

2. ANXHELA AGA

Te cilet mund të ushtrojnë kompetencat e tyre së bashku, ose edhe veç e veç.

NENI 9 DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.



Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane 03/02/2021

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE
"EMAAR JOINT STOCK COMPANY FOR THE
CONSTRUCTION AND DEVELOPMENT OF
CITIES AND TOURIST COMPLEXES" SH.P.K.**

HUSSEEN MAHMOD ABAAS AL-JBUORY

حسين الجبوري
حسي